



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit – “Radio Star”

Numri Unik Identifikues: 810155425

Pronari: Xhavit Salihu

OSHMA: Radio Star

Adresa: Rr/Lagja Dardania –

Rruga/Muharrem Ibrahim-13/1

Emri i biznesit: Arbresh Salihu B.I.

Emri i Tregtar: “Radio Star NUI: 810155425”

Kandidati për pronar: Arbresh Salihu

OSHMA: Radio Star

Adresa: Rr/Lagja Dardania –

Rruga/Muharrem Ibrahim-13/1



VENDIM

për ripërtëritjen dhe bartjen e licencës së “Radio Star”, me seli në Komunën e Gjilanit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Star është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios, me seli në Komunën e Gjilanit. KPM, me datën 28 gusht 2016 ka bërë ripërtëritjen e licencës Radio Star së për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa me datën 28 gusht 2023 skadon afati i kësaj licence.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Star, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 10 maj 2023, Radio Star ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.
5. Më datën 07 dhjetor 2022, Radio Star ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Star nga pronari paraprak Xhavit Salihu (i cili ka ndërruar jetë), nga biznesi individual “Radio Star” me numrin Unik Identifikues, 810155425, tek kandidati për pronari të ri (djali i tij)

Arbresh Salihu tek biznesi me emër Arbresh Salihu B.I. me emrin tregtar “Radio Star” me Numër Unik Identifikues (NUI) 810155425.

6. Kërkesa për bartje të licencës nuk ka mundur të shqyrtohet me kohë për arsye se Komisioni nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje nga data 15 tetor 2022 deri më 6 qershor 2023, si dhe grumbullimi të një numri të madh të lëndëve për këtë periudhë kohore,

Arsyetim

7. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
8. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
9. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Star lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
10. Komisioni konstaton se, Radio Star përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar si dhe ndryshim të pjesës së dytë të Licencës (Standardet Teknike dhe kushtet e licencës)
11. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Star të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
12. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.*
13. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
14. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*

15. Neni 15.5 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që *“Në rast se i Licencuari vdes, ose vërtetohet paaftësia e tij shëndetësore me anë të vendimi gjyqësor apo përmes një dokumenti shëndetësor, ose i Licencuari si organizatë ndërpret veprimtarinë, shpërbëhet ose deklarohet i falimentuar nga një autoritet kompetent, KPM-ja mund ta përfundojë Licencën ose t’ia transferojë Licencën një pasardhësi të kualifikuar.”*
16. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë Radio Star është deklaruar se arsye për këtë ndryshim është vdekja e pronarit të deritanishëm z. Xhavit Salihut dhe bartja e biznesit në emrin e të birit z. Arbresh Salihu. Ndërsa është dorëzuar edhe dëshmia nga organet kompetente lidhur me vdekjen e z. Xhavit Salihu ashtu siç kërkohet me Nenin 15, paragrafi 5 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM.
17. Gjithashtu, kandidati për pronar të ri z. Arbresh Salihu ka kërkuar edhe miratimin për ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në regjionale dhe sipas arsyetimit përmes këtij ndryshimi shpreson në shtrirje më të gjerë dhe si rrjedhojë në dëgjueshmëri dhe përfitime më të mëdha të cilat kontribuojnë në vetë qëndrueshmërinë e subjektit transmetues, mirëpo që lidhur me këtë kërkesë kanë munguar informacionet lidhur me lokacionin e propozuar, lartësinë mbi detare si dhe koordinatat e nevojshme për atë lokacion për të kryer matjet e nevojshme teknike.
18. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Star (kandidati), përmes një deklaratë me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
19. Komisioni konstaton se Radio Star ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ndryshim të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
20. Duke marr përsyshë faktin e vdekjes së pronarit të deritanishëm dhe të drejtën për bartje të licencës tek një trashëgimtarë i kualifikuar, gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, angazhimin e stafit profesional zotimet për rritjen e cilësisë dhe llojeve të programeve, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Star është në interes të publikut.
21. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Star është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Star i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon kjo radio.


Vendim

22. Komisioni në takimin e datës 1 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës së Radio Star në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Star.

23. Komisioni merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Star nga pronari paraprak Xhavit Salihu nga biznesi individual "Radio Star" me unik identifikues, 810155425, tek kandidati për pronari të ri (djali i tijë) z. Arbresh Salihu tek biznesi me emër Arbresh Salihu B.I. me emrin tregtar "Radio Star" me Numër Unik Identifikues (NUI) 810155425.
24. Komisioni merr vendim për refuzim të kërkesës për ndryshimin e kategorisë së radios për arsyet e cekura më lartë, ndërsa Radio Star do të ketë mundësi të parashtror në të ardhmen përsëri kërkesë për këtë ndryshim duke dorëzuar kërkesë të kompletuar.
25. Licenca e Radio Star do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.
26. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Star, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.

E drejta e Ankesës

27. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafin 5 të Ligjit të KPM. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji.
28. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
29. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.09.2023

datë